

SHTETI I NJU-JORKUT, COVID-19 MUND TË PËRHAPET SHPEJT.

**NËSE JENI I SËMURË APO MENDONI
SE KENI QENË I EKSPOZUAR, MOS
PRISNI. IZOLOHUNI!**

PROGRAMI TAKE CARE I NYC TEST & TRACE CORPS ËSHTË KËTU PËR TË NDIHMUAR ME

Një dhomë hoteli pa pagesë dhe të sigurt ku përfshihen

- **Ushqim pa pagesë (3 vakte në ditë)**
- **Wifi, televizion kabllor dhe telefonata pa limit brenda vendit, të gjitha pa pagesë**
- **Dërgesë e përditshme e barnave**
- **Personel mjekësor në vend**

Nëse hoteli nuk është i përshtatshëm për ju, mund t'ju ndihmojmë të lidheni me burime në mënyrë që të izoloheni në mënyrë të sigurt në shtëpi.

Të gjithë njujorkezët janë të pranueshëm, pavarësisht statusit të emigrantit.

Programi Take Care mund t'ju ndihmojë gjithashtu të merrni leje të paguar për arsye shëndetësore nëse jeni i pranueshëm, prandaj nuk kenë pse të shqetësoheni për mungesat në punë.

Telefononi linjën telefonike të Test & Trace Corps në numrin 212-COVID19 ose vizitoni nyc.gov/takecare për të përfituar ndihmë pa pagesë!



ÇFARË MUND TË BËNI PËR TË LUFTUAR COVID-19

TESTIM




Informohuni për statusin tuaj. Përfitoni një test për COVID-19 pa asnjë kosto për ju.

GJURMIM



Përgjigjuni telefonatës nga gjurmuesit tanë të kontaktit për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

KUJDES PËR VETEN



Izolohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjerët dhe kujdesuni për veten në një hotel ose në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është i përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave tuaja personale dhe shëndetësore. Çdo informacion që marrim është konfidencial dhe i mbrojtur në përputhje me Kodin Shëndetësor të Qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk bën pyetje rreth statusit të emigrantit të askujt.